



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 10537 Prot.

Tiranë, më 16.10. 2017

UDHËZIM

Nr. 23, datë 16.10.2017

**PËR  
DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 15, DATË 19.05.2017 “PËR PROCEDURAT E  
PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2017-2018”, I  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 9 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Në pikën 2, gërma “C” e kreut III të Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017, të ndryshuar, shtohet si më poshtë:

*“2. Gjatë periudhës 16 deri 26 tetor, institucionet e arsimit të lartë, vijojnë me procedurat e regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet portalit u-albania, në programet e studimit në të cilat kanë aplikuar në raundin e parë apo të dytë. Të drejtën e regjistrimit e kanë kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi. Institucionet e arsimit të lartë gjatë regjistrimeve respektojnë renditjen e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave. Procedurat për regjistrimin e kandidatëve përcaktohen nga njësitë kryesore të IAL-ve.”.*

2. Pika 4 e Gërmës “C”, të Kreut III të Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

*“4. Në rast se përfundon e gjithë lista e kandidatëve që kanë aplikuar në raundin e dytë dhe mbeten kuota të paplotësuara në programet përkatëse të studimit, njësitë bazë në institucionet e arsimit të lartë, përzgjedhin kandidatët fitues sipas kërkesave të depozituara nga kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, pavarësisht përzgjedhjeve në raundin e parë apo të dytë. Kandidatët përzgjedhin dhe rankohen nga njësitë bazë dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore duke njoftuar QSHA-në dhe duke i ngarkuar një kopje elektronike të këtyre listave në portalin u-albania. Sekretaritetë mësimore regjistrojnë kandidatët e miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore sipas renditjes deri në plotësimin e kuotave për programet përkatëse të studimit.”.*

*Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 16 deri më datë 26 tetor 2017 nëpërmjet dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim.*”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

*Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.*

**LINDITA NIKOLLA**

**MINISTËR**

